

**URDHËR**  
**Nr. 87, datë 23.2.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT MINIMAL TË NOTERËVE PËR NJË DEGË**  
**VENDORE DHE PËR MIRATIMIN E KUFIJVE TERRITORIALE TË DEGËVE**  
**VENDORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 79, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 110/2018, “Për Noterinë”,

**URDHËROJ:**

1. Dhoma Kombëtare e Noterisë organizohet në 6 (gjashtë) degë vendore, për çdo zonë ku shtrin kompetencën e saj tokësore një gjykatë apeli.
2. Kufijtë territorialë të degëve vendore dhe numri i noterëve për çdo degë është sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet struktura përgjegjëse për noterinë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË**  
**Etilda Gjonaj (Saliu)**

**Aneks nr. 1**

<b>Dega vendore</b>	<b>Kufijtë territorialë</b>	<b>Numri i noterëve të degës vendore</b>
Dega Vendore e Noterisë Tiranë	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Tiranë, Vorë dhe Kamzë	<b>49 noterë</b>
Dega Vendore e Noterisë Durrës	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Kavajë, Elbasan, Belsh, Përrenjas, Cërrik, Krujë, Peqin, Gramsh dhe Librazhd	<b>40 noterë</b>
Dega Vendore e Noterisë Shkodër	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Shkodër, Dibër, Tropojë, Pukë, Kukës, Bulqizë, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Mat, Klos, Mirditë, Fushë-Arrëz dhe Has	<b>36 noterë</b>
Dega Vendore e Noterisë Korçë	Shtrihet në kufijtë territorialë të Bashkive Korçë, Pogradec, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pustec	<b>14 noterë</b>
Dega Vendore e Noterisë Vlorë	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Vlorë, Fier, Mallakastër, Lushnjë, Patos, Skrapar, Berat, Kuçovë, Poliçan, Ura Vajgurore, Divjakë, Roskovec dhe Selenicë	<b>38 noterë</b>

Dega Vendore e Noterisë Gjirokastrë	Shtrihet në kufijtë territorialë të bashkive Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Himarë, Dropull, Finiq, Libohovë, Konispol dhe Këlcyrë	<b>12 noterë</b>
---	--	------------------